

UNIVERSALJA NË VEPRËN E MIGJENIT

Esmije VESELI¹^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova^{*}Corresponding author e-mail: esmije.veseli@unite.edu.mk

Migjeni la pas vetes një lëndë letrare, të shkruar në poezi e prozë, e cila jo vetëm që është lexuar dhe lexohet, por edhe rilexohet vazhdimisht, qoftë nga lexuesit e pasionuar pas letërsisë, qoftë nga lexuesit e specializuar. Vepra letrare e Migjenit është *Një sfinks i madhnueshëm, para të cilit njeriut ia bren trutë enigmi*.³⁶ Migjeni, përmes një vështrimi artistik, nëpërmjet shqisës së tij prej shkrimtari të lindur, krijon një botë alternative, një botë të sajuar, e cila i përngjan botës reale. Ai merr nga bota reale aq sa i duhet për të krijuar vetëdijen e tij artistike.

Në këtë botë ka vuajtje dhe tmerr, uri dhe sakrificë, përbuzje dhe përçmim, fatalizëm e zhgënjim, pesimizëm të thellë dhe rënie morale, por ka gjithashtu edhe shpresë, një shpresë të “*Bijtë e shekullit të ri*”, një shpresë të një forcë e re, e heshtur, e fshehur, e cila nuk e pranon gjendjen si është, por dëshiron një botë të re, një jetë të re, një ardhmëri të suksesshme. I tillë është vetë shkrimtari i ri në moshë, me ide të reja, me vizion të ri, me një ndjeshmëri tjetër artistike, i pasur shpirtërisht, me një gjuhë tjetër dhe të dallueshme nga paraardhësit e tij dhe nga bashkëkohësit.

Migjeni është njëri nga ata që i paraqiti të gjitha dukuritë shoqërore të kohës deri në imtësi. E njeh sipërfaqen e saj, por edhe thellësinë e saj të padukshme sepse, vetëm duke e njohur, kjo shoqëri mund të ndryshohet. *Meditimet ekzistenciale të Migjenit mund të të pëlqejnë, por mund edhe të të mos pëlqejnë, por s’mund t’u mohohet atyre thellësia filozofike, përmbajtja humanitare dhe shprehja ekspresive groteske*.³⁷

Përkundër veshjeve nga kritika ideologjike, Migjeni parapëlqente evolucionin, përsosjen morale e intelektuale të njeriut, kërkonte lirinë personale të mendimit, dhe gjëra tjera që ishin të theksuara por të padukshme nga ana e pushtetit dhe tjetrit. Tema zotëruese në krijimtarinë letrare ishte fati i njeriut, fatkeqësia e tij dhe në pak sekuenca edhe lumturia e tij. Migjeni shkroi poezi dhe prozë. Përmbledhjen poetike *Vargjet e lira* e shkroi brenda një periudhe trevjeçare (1933-1935).

Ai nuk arriti që ta shihte të botuar, sepse u censurua nga regjimi i Mbretit Zog, për shkak se binte në kundërshtim me veprimet dhe platformën e tij politike. Kjo përmbledhje poetike na ngjall emocione dhe ndjenja gjatë çdo leximi apo rileximi, teksa atmosfera e shpalosur është shumë e përafërt (në mos identike) edhe me kohën tonë. Mund të themi lirisht se vepra e Migjenit mbetet me horizont të hapur pritjeje, prandaj lexohet, interpretohet, studiohet, teksa çdo lexues zbulon shtresa të reja kuptimore të kësaj krijimtarie të pasur artistikisht.

Përveç përmbledhjes poetike *Vargjet e lira*, Migjeni e provoi veten në prozë dhe shënoi kulmet e tij edhe në këtë zhanër letrar. Shkroi gjithsej 33 krijime të ndara në skica letrare e novela.

³⁶ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare* (përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu) Dukagjini, Pejë, 1997, f. 313.

³⁷ Alfred Uçi, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, Vatra, Shkup, 2003, f. 23.

Skicat kryesisht janë të ndara dhe ndryshojnë për nga mënyra e trajtimit të problemit të secila prej tyre: për nga toni emocional, për nga shprehjet dhe gjuha, për nga trajtimi i personazheve etj. Nëse bëjmë një krahasim midis Migjenit dhe shkrimtarëve të kësaj periudhe, do të vërejmë se prozat e Migjenit kanë më tepër nota ironike-tragjike, se sa humoristike -satirike, siç ishin ato të Nonda Bulkës. Po ashtu, proza e Migjenit dallohet edhe për nga intonacioni, trajtimi i realitetit, që është pjesa origjinale e veprës, bota e veçantë poetike, kurse vend të rëndësishëm zë edhe ana figurative, pra ironia, sarkazma, alegoria, por ndonjëherë edhe groteskja.

Te skicat vërejmë idenë e moszgjidhjes së problemit të shumëtrajtuar, sikundër ishte realiteti shoqëror dhe ai ekzistencial. Te krijimi “*Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun*”, që është më i veçanti në çdo pikëpamje, autori vë në pah dy pole etike të kundërta: *vuajtjen dhe kënaqësinë, animanilitetin dhe njerëzishmërinë, përsosurinë shpirtërore dhe katandisjen morale shpirtërore*.³⁸ Kjo skicë fund e krye është e përshkuar me një mllef të autorit që e ka konsumuar gjatë gjithë kohës, pa mos e gjetur një mes në planin shoqëror e intelektual. Fytyrën e derrit e paraqet me fizionominë e Sokratit, e fytyrën e Sokratit me fizionomine e derrit, kështu që njeriu e vë në tallje vetveten që është forma më e ulët e intelegjencës së tij.

Edhe te alternativa “*Ose...Ose*” që në fillim ky krijim të jep një emocion tjetër, një botëkuptim tjetër, një imazh tjetër. Masa punonjëse në këtë rast është vendosur në një zonë neutrale të vazhdojë njerëzia të lozi rolin e Hamletit të çmendun –apo të filloj lojën e Don Kishotit, lojën plot avantura (por avantura të domosdoshme).³⁹ Dilema është se këta njerëz do të çohen drejt një revulucioni, drejt një ardhmërie më të përparuar ose të vazhdojnë të jetojnë jetën stërgjyshore. Edhe te dilema “*Tragjedi apo komedi*” shohim njeriun e vuajtur dhe të pambrojtur. Ai bie viktimë e kohës ngase fati i tij ishte në duart e fuqishme dhe shkatërruese të shoqërisë, së këndejmi nuk di se çfarë roli t’i japë vetvetes.

Dilemat e këtilla, përpos që vënë në dyshim shoqërinë e kohës me të gjithë kapacitetet e saj, gjithashtu krijojnë edhe një droje për të ardhmen e vendit. Një dëshirë e shprehur paraprakisht me nota optimiste, tani sikur zëvendësohet nga një dilemë: nëse njeriu do të vazhdojë me avazin e vjetër ose, pas shumë flijimeve, do të ripërtërihet, gjithnjë duke pasur si pretekst vuajtjet të cilat ia caktoi jeta. Ai shprehet kështu: *Mbrapa gjithë kësaj që thashë, nuk dihet një! A ka me sjellë historiku fletën krejtë të re, të shkruejë-apo do vazhdojë fletën e vjetër? Mos asht dhe kjo vetëm një ironi kohe?*⁴⁰

Një lloj tjetër skicash kanë tjetër karakter dhe tjetër tematikë. Trajtohet, kryesisht, tema shoqërore dhe ekzistenciale, me personazhe të natyrave të ndryshme, siç janë: lypësit, të papunët, personazhi femër, që zë kryevendin në gjithë opusin krijues etj. Nëse flasim për personazhin e vogël, që përfaqëson lypësin, në të gjithë format, atëherë shumë bukur vërehet figura e tij në skicën “*Në kishë*”, ku ky ishte i detyruar që të kalonte nëpër të gjitha labirintet më të rrezikshme të jetës, vetëm për një copë bukë.

Ky personazh e kuptonte mirësjelljen e “*zotnive të kohës*”, e kishte mësuar refrenin, por ajo çka e prek në intimitet janë fjalët e priftit drejtuar lypsarëve, duke iu kërcënuar dhe duke përdorur fjalë më të vrazhda. Edhe në skicat tjera, figura e lypësit trajtohet po me të njëjtin intensitet dhe përçmim. Kjo vërehet në skicat “*A do qymyr, zotni*”, “*Luli i vocër*”, “*Zoti të dhashtë*” etj., që vetëm për një kore buke bëhen lodër e shoqërisë.

Në skicën „Luli i vocër” autori na përshkruan gjendjen e vështirë ekonomike e shpirtërore të vogëlushit. Përmes Lulit dhe tullumbave të tij Migjeni realizoi figurën e vërtetë të një vogëlushi

³⁸ Sefedin Fetiu, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1984, f. 118.

³⁹ Migjeni, *Prozë 1*, Rilindja, Prishtinë 1977, f. 11.

⁴⁰ Migjeni, *Prozë 2*, Rilindja, Prishtinë 1977, f. 12.

të shtresës së varfër, që e kishte shkatërruar uria. Edhe te krijimi „*Zoti të dhashtë*” paraqitet skena e dhimbshme e lypësit që endet rrugëve për një kore buke. Fakti që Migjeni nuk e pagëzoi lypësin me një emër ishte e qartë, për shkak se të tillë individë ishin shumë. Shtresa e varfër i pagoi të gjitha dënimet që u kishte servuar shoqëria e kohës, sepse nuk kishin as përkrahje morale, as financiare.

Përpos këtyre skicave, që janë të përqendruar te lypësi, një tjetër skicë e ka në epiqendër njeriun e papunë, i cili endet rrugëve të qytetit pa asnjë synim, pa asnjë destinim, duke shkuar atje ku e shpie fuqia e këmbëve, teksa rrugët shtrihen para tij si të pafundme (*Moll' e ndalueme*). Skica, e cila do të mbetet si një nga më të veçantat e krijimtarisë prozaike të Migjenit, është „*Legjenda e misrit*”, e cila trajton një temë shumë ekzistenciale të njeriut.

Duhet thënë se skicat e Migjenit janë të veçanta si për nga forma, ashtu edhe nga mënyra se si trajtohen problemet ekzistenciale. Në krijimet më të gjata që i titulloi „*Novelat e Qytetit të Veriut*”, Migjeni trajtoi tema ekzistenciale nga realiteti shqiptar, i cili nuk dallonte edhe nga realitetet e tjera shoqërore dhe kulturore. Në brendinë e këtyre subjekteve hasim frymën e njëjtë: mjedise të njëjta, personazhe të njëjtë, mënyrën e shkrimit të tij, kurse e veçanta e novelave mbetet mënyra e trajtimit të figurës së gruas, duke e futur në skutat më të errëta të realitetit. Paraqitet „prostituta”, që shet nderin e saj për kafshatën e bukës.

Në gjashtë novelat, duke filluar nga „*Studenti në shtëpi*”, „*Të çelen arkapijat*”, „*Historia e njëjës nga ato*”, „*Pak poezi*”, „*Bukën tonë të përditshme falna sot*” dhe „*M'at anë gardhit asgjë të re*”, autori ka përdorur të njëjtin ritëm dhe të njëjtin intensitet krijues. Personazhi femër mban barrën e gjithë katastrofave morale, duke e detyruar të bëhet lodër e secilit. Krijimi ku kjo qenie njerëzore vërehet si më e shkatërruar moralisht dhe fizikisht, është „*Historia e njëjës nga ato*” (Lukja). Te një krijim tjetër (*Bukën tonë të përditshme falna sot*), ku sërish shfaqet kjo figurë, është nëna e Lilit, e cila bëhet viktimë e realitetit, si pasojë e çrregullimeve dhe devijimeve shoqërore. Këtë personazh, që në fillim na shfaq tiparet e njeriut të vlefshëm dhe të moralshëm, që u shërbente si mostër gjeneratave që vinin pas.

Shkaqet ekonomiko-shoqërore dhe sëmundja e djalit e vunë edhe atë në radhët e shfrytëzimit dhe degjenerimit total. Një krijim, pak më i veçantë, për sa i përket natyrës së qasjes, është skica „*Pak poezi*”, në të cilën autori vë në qendër një dashuri jashtë normave morale. Lili nuk kishte faj që nenet e etikës kundërshtojnë dashurinë e cila nuk respekton ligje e kanune, por duke mos dashur të bëhet protagonist i thyerjes së këtyre normave, ai parapëlqen ta braktisë vetveten, me mendimin se do ta harronte Lilushen.

Pikërisht këto vullkane shpirtërore do të ndjekin edhe shumë të rinj të kohës, që fatkeqësisht ishin të detyruar moralisht të respektojnë çdo procedurë apo kanun, për shkak se nuk e kishin fuqinë e duhur për t'i kundërvënë atyre normave të mykura shekullore. Si përfundim, mund të themi se Migjeni arriti ta zgjerojë fokusin e tematikës në krijimtarinë letrare personale, por edhe të letërsisë shqiptare, prandaj edhe e ka vendin e tij të merituar dhe të pakontestueshëm në historinë e letërsisë shqipe.

Referencat

- [1]. Migjeni (1977), *Prozë 1*, Rilindja, Prishtinë.
- [2]. Migjeni (1977), *Prozë 2*, Rilindja, Prishtinë.
- [3]. Elsie, R. (1997), *Historia e letërsisë shqiptare* (përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu) Dukagjini, Pejë.
- [4]. Fetiu, S. (1984), *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [5]. Uçi, A. (2003), *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, Vatra, Shkup.